



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“SHOQERIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME” DIBËR SH.A

Nr. _____ Prot.

Datë _____.____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Data: 29.07.2024

Drejtuar: Operatorit Ekonomik, me të dhënat si më poshtë:

- Shoqëria Liqeni VII sh.p.k me NIPT K01730502W me adresë: Durrës, Shkozet, Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007.

Procedura e prokurimit: Proçedurë e hapur me mjete elektronike / Punë.

Numri i referencës së proçedurës: **REF-10319-06-20-2024**

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45000000-7 – Punë ndërtimi.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *“Furnizimi me ujë i fshatit Rreth Kale, Njësia Administrative Muhur”.*

Afati kohor për ekzekutimin: 6 (gjashtë) muaj

Fondi limit: 61,996,857 (gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme: Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi, ju informojmë se në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. Bashkimi Operatorëve Ekonomik **Shoqëria B93 II sh.p.k** me NIPT **L522090500 Sh.p.k & Shoqëria BEQIRI** me NIPT **J98624801V**, me adresë: Durrës,Rruga “Miqesia’’,Njesa Administrative Spitalle.
Vlera e Ofertës: 54,222,208 (pesëdhjetë e katërmilion e dyqind e njëzetë e dymijë e dyqind e tetë) lekë pa TVSH.**
- 2. Operatori Ekonomik **Shoqëria Balili Konstruksion sh.p.k** me NIPT **K17016202S Sh.p.k** me adresë: Tiranë,Kompleksi Garden Residence Turdiu,Kulla B,Zyra.211,Rruga Andrea Kushi.
Vlera e Ofertës: 61,592,683 (gjashtëdhjetë e njëmilion e pesëqind e nëntëdhjetë e dymijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.**
- 3. Operatori Ekonomik **Shoqëria Desaret Company sh.p.k** me NIPT **K01816001J Sh.p.k** me adresë:Tiranë Njësia Bashkiake nr 11, Rruga" Hysni Gerbolli", Pallati "Desaret",Prane Kryqit te Kuq.
Vlera e Ofertës: 42,519,894.02 (dyzetë e dymilion e pesëqind e nëntëmbëdhjetëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër pikë zero dy) lekë pa TVSH.**
- 4. Operatori Ekonomik **Shoqëria Ideal Construction And Projection (I.C.P) sh.p.k** me NIPT **L91310511L**, me adresë: Durrës, Lagjja nr.18, Rruga Aleksandër Goga, Pallati 788, Shk.1, K.1, Ap.2, Pasuria numër 29/70+1-211, Zona Kadastrale 8511
Vlera e Ofertës: 60,852,609.67 (gjashtëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë dymijë e gjashtëqind e nëntë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.**
- 5. Operatori Ekonomik **Shoqëria Kupa sh.p.k** me NIPT **K51615512C**, me adresë:Tirane, Kamez, Rruga Berisha, Argjjinatura me nr.pasurie 482, Çërkeze.
Vlera e Ofertës: 61,086,178.21 (gjashtëdhjetë e njëmilion e tetëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë njëzetë e një) lekë pa TVSH.**
- 6. Operatori Ekonomik **Shoqëria Liqeni VII sh.p.k** me NIPT **K01730502W** me adresë: Durrës, Shkozet, Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007
Vlera e Ofertës: 58,124,671 (pesëdhjetë e tetëmilion e njëqind e njëzetë e katërmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH.**
- 7. Operatori Ekonomik **Shoqëria LIS KONSTRUKSION sh.p.k** me NIPT **K66613407H** me adresë: Tirane, Njesia Nr. 7, Zona Kadastrale 8250, me Nr. Pasurie 1/65ND+2-24, Rruga Sali Butka, Pallati CANI, Shkalla 1, Ap. 24
Vlera e Ofertës: 61,396,666.70 (gjashtëdhjetë e njëmilion e treqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.**
- 8. Operatori Ekonomik **Shoqëria S I R E T A 2F sh.p.k** me NIPT **K51501008J sh.p.k**, me adresë: Tiranë, Paskuqan, Lagjia Babrru Fushe, Komuna Paskuqan
Vlera e Ofertës: 61,111,111 (gjashtëdhjetë e njëmilion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.**

9. Operatori Ekonomik **Shoqëria S.M.O.Union sh.p.k** me NIPT **J66902042Q**, me adresë: Tirane, Rruga Siri Kodra, Hyrja 1, Ap 4 , zona kadastrale 8360, nr pasurise 4/239-N4.
Vlera e Ofertës: 60,732,183 (gjashtëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë dymijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.
10. Operatori Ekonomik **Shoqëria "SARDO" sh.p.k** me NIPT **K13120402W** me adresë: Fier, Lagjja Apollonia, rruga Xoxi Andoni, pallati 8 katesh me nr - 89, kati i pare.
Vlera e Ofertës: 60,244,136 (gjashtëdhjetë milion e dyqind e dyzetë e katërmijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Oferta të refuzuara:

1. Bashkimi Operatorëve Ekonomik **Shoqëria B93 II sh.p.k** me NIPT **L522090500 Sh.p.k & Shoqëria "BEQIRI"** me NIPT **J98624801V**, me vlerë të ofertës: 54,222,208 (pesëdhjetë e katërmilion e dyqind e njëzetë e dymijë e dyqind e tetë) lekë pa TVSH.

S`kualifikohet

Arsyet si vijon:

Autoriteti Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky Operator Ekonomik konstatoi se nuk plotëson kriteret e DST-së. Konkretisht **Shtojca 1 Formulari i Ofertës dhe Shtojca 2 Lista e Cmimeve** nuk janë plotësuar sipas formatit të DST-së së publikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Ky bashkim operatorësh ekonomik nuk ka paraqitur sipas **pikës 2.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: 2.3.1.** Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*
- b. *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).*

Kontratat e ngjashme të paraqitura në SPE nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik rezultojnë të një natyre jo të ngjashme me objektin e prokurimit, si argjinatura, kanale vaditëse, kanale kulluese etj.

Gjithashtu të marra të gjitha sëbashku nuk plotësojnë pikën b. *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).*

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik nuk përmbush kriterin **2.3.6** të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional në lidhje me makineri pajisje, pasi nga dokumentacioni i dorëzuar në SPE rezulton se ky Bashkim Operatorësh nuk disponon Buldozer.

Në përfundim të vlerësimit elektronik, ky Bashkim Operatorësh Ekonomik **S`Kualifikohet.**

2. Operatori Ekonomik **Shoqëria Balili Konstruksion sh.p.k** me NIPT **K17016202S Sh.p.k** me vlerë të Ofertës: 61,592,683 (gjashtëdhjetë e njëmilion e pesëqind e nëntëdhjetë e dymijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

S`kualifikohet

Arsyet si vijon:

Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik në SPE për këtë procedurë prokurimi rezulton se: Operatori Ekonomik **Shoqëria Balili Konstruksion sh.p.k** nuk ka paraqitur sipas pikës 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: pika a) Liçensën profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës të vlefshme.

Nuk disponon licencat e mëposhtme:

NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

Klasifikimi C

NS-14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni Tv,etj

Klasifikimi A

NS-18 Punime topogjeodezike.

Klasifikimi A

Operatori Ekonomik **Shoqëria Balili Konstruksion sh.p.k** nuk ka përmbush numrin mestar të punonjësve të kërkuar sipas pikës 2.3.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit:

Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën 55 (pesëdhjetë e pesë) punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.

Gjithashtu nuk plotëson pikën 2.3.3 a) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ku kërkohet që:

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, Drejtuesit Teknik si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

Operatori ekonomik nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE rezulton se nuk ka të punësuar: Inxhinier mjedisi, Inxhinier hidroteknik dhe ndërtimi si dhe numri mesatar i të punësuarve është 28 punonjës nga 55 që kërkohen duke mos përmbushur kërkesat e bëra nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Operatori Ekonomik **Shoqëria Balili Konstruksion sh.p.k** nuk plotëson pikën 2.3.3 c) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ku kërkohet që;

c) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën 17 (shtatëmbëdhjetë) punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit.

Operatori ekonomik nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE rezulton se ka të punësuar: 1 teknik ndërtimi nga 2 që kërkohen, 1 saldator ndërtimi nga 2 që kërkohen, nuk ka hidraulik, nuk ka elektrikist, nuk disponon karpentier, nuk ka hidroizolues, murator si dhe specialist për punime betonim, gjithashtu disponon 1 eskavatorist nga 2 që kërkohen, 1 automakinist nga dy që kërkohen si dhe asnjë buldozierist sipas pikës 2.3.3 e; gjithashtu sipas verifikimit të dokumentacionit vërehet se nuk disponon as një mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë, si dhe 1 (një) punonjës specialist si Ekspert zjarrëfikës në fushën e

mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, duke mos përmbushur kërkesat e bëra nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Operatori Ekonomik **Shoqëria Balili Konstruksion sh.p.k** nuk ka paraqitur sipas pikës 2.3.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”*

Ky operator ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional, pasi në dokumentacionin e ngarkuar në SPE nuk ka ngarkuar asnjë dokumentacion për materialet hidraulike, autorizim prodhuesi, katalog për tuba, saracineskat.

Nuk përmbush kriterin **2.3.6** të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional në lidhje me makineri pajisje pasi nuk ka paraqitur makineritë:, Autovinc, Mineskavator, Minifadromë, Autobetoniere, Autopompë, Autobot uji me sprucator, Autobitumatrice, Asfaltoshtruese, Autorimorkiator mjetesh, Motogjenerator / Gjenerator, Saldatrice / motosaldatrice, Pajisje për hekurkthyes (tranxhe / elektrobango), Kompresor ajri, Depozitë uji 5000 lt, Sharrë asfalti, Pompë uji për pastrim Betoniere kantieri, Nivelues Betoni, Aparat saldimit MIG TIG, Pajisje për testimin e presionit, Pompë presioni për testim hidraulik, Buldozer.

Gjithashtu Operatori ekonomik nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika **2.3.6**. Makineri Pajisje , pasi nga dokumentacioni i dorëzuar në rrugë elektronike rezulton se OE nuk disponon mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore mbrojtëse+ Jelekë fosforoshente minimumi 40 (dyzetë) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2(dy) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjetë) copë.

Në përfundim të vlerësimit elektronik, ky Operator Ekonomik **S’Kualifikohet.**

3. Operatori Ekonomik Shoqëria Desaret Company sh.p.k me NIPT K01816001J Sh.p.k me vlerë të Ofertës: 42,519,894.02 (dyzetë e dymilion e pesëqind e nëntëmbëdhjetëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër pikë zero dy) lekë pa TVSH.

S’kualifikohet

Arsyet si vijon:

Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik në SPE për këtë procedurë prokurimi rezulton se: Operatori ekonomik nuk ka përmbushur pikën **2.3.5.1 dhe 2.3.5.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit; Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

1. *Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributor i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave nënshkruar jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast*

verifikimi nga ana e tij. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Nga dokumentacioni i dorëzuar në rrugë elektronike rezulton se në autorizimin e ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik nuk tregohet lidhja Prodhues-Distributor ofertues. Gjithashtu rezulton se referuar grafikut të punimeve të dorëzuar nga OE ofertueses nuk është i vlefshëm deri në realizimin e plotë të punimeve ashtu sikurse është kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit. (Afati deri në 1 Janar 2025).

2. *Katalogun / et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit / ve për listënn e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

Katalogët e ngarkuar nga Operatori Ekonomik në SPE nuk specifikojnë qartë cili është produkti që do të furnizohet, duke mos përmbushur kërkesat e bëra nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Gjithashtu Operatori ekonomik nuk ka përmbushur pikën **2.3.6 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit** publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional në lidhje me makineri pajisje pasi ky operator sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE nuk disponon Autobotumatrice, makineri e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor si kusht i domosdoshëm për realizimin e objektit të procedurës së prokurimit.

Në përfundim të vlerësimit elektronik, ky Operator Ekonomik S'**Kualifikohet.**

4.Operatori Ekonomik Shoqëria Ideal Construction And Projection (I.C.P) sh.p.k me NIPT **L91310511L**, me vlerë të Ofertës: 60,852,609.67 (gjashtëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë dymijë e gjashtëqind e nëntë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

S`kualifikohet

Arsyet si vijon:

Operatori Ekonomik **Shoqëria Ideal Construction And Projection (I.C.P) sh.p.k** nuk ka paraqitur sipas pikës 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: pika a) Liçensën profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës te vlefshme, për kategoritë e mëposhtme, pasi nga dokumentacioni i dorëzuar në SPE rezulton se OE nuk ka pikat e licensës:

NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

Klasifikimi C

NS-9 Punime strukturore speciale.

Klasifikimi B

Operatori Ekonomik **Shoqëria Ideal Construction And Projection (I.C.P) sh.p.k** nuk ka paraqitur sipas pikës 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: pika a) Liçensën profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës te vlefshme, për kategoritë e mëposhtme, pasi nga dokumentacioni i dorëzuar në SPE rezulton se OE nuk disponon kategoritë e pikave të Licensës:

NP-1 Punime gërmimi në tokë.

Klasifikimi C

(OE disponon katergorinë A)

NP-7 Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje.

Klasifikimi B

(OE disponon katergorinë A)

Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik në SPE për këtë procedurë prokurimi rezulton se nuk ka paraqitur sipas pikës 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: pika certifikatat ISO të kërkuara në DST, konkretisht i mungon;

- Certifikatë SSH EN ISO 3834-2 :2021 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- Certifikatë ISO 39001-2012 “Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në Trafikun Rrugor”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Operatori Ekonomik **Shoqëria Ideal Construction And Projection (I.C.P) sh.p.k** nuk ka përmbush numrin mestar të punonjësve të kërkuar sipas pikës 2.3.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit:

Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën 55 (pesëdhjetë e pesë) punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.

Gjithashtu nuk plotëson pikën 2.3.3 a) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ku kërkohet që;

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, Drejtuesit Teknik si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik .

Operatori ekonomik **Shoqëria Ideal Construction And Projection (I.C.P) sh.p.k** nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE rezulton se nuk ka të punësuar: Inxhinier mjedisi, si dhe inxhinier elektrik, si dhe numri mesatar i të punësuarve është 24 punonjës nga 55 që kërkohen duke mos përmbushur kërkesat e bëra nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur sipas pikës 2.3.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”*

Gjithashtu ky operator ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional, pasi në dokumentacionin e ngarkuar në SPE nuk ka ngarkuar asnjë dokumentacion për materialet hidraulike, autorizim prodhuesi, katalog për tuba, saracineskat.

Nuk përmbush kriterin **2.3.6** të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional në lidhje me makineri pajisje pasi nuk ka paraqitur pothuajse të gjitha makineritë e kërkuara si: Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 1.5 ton, Autovinc, Eskavator me zinxhir, Eskavator me goma, Minieskavator, Minifadromë, Autobetoniere, Autopompë, Autobot uji me sprucator, Autobitumatrice, Asfaltoshtruese, Autorimorkiator mjetesh, Rul ngjeshës gomë-hekur jo më pak se 10 ton, Rrul asfalti gomë-gomë, Rrul i vogël deri 6 ton, Pajisje për hekurkthyes (tranxhe / elektrobango), Kompresor ajri, Depozitë uji 5000 lt, Sharrë asfalti, Tokmak për ngjeshje, Vibrator betoni, Betoniere 0.5m³, Nivelues Betoni, Aparart saldimi MIG TIG, Pajisje për testimin e presionit, Pompë presioni për testim hidraulik, Buldozer nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Në përfundim të vlerësimit elektronik, ky Operator Ekonomik **S’Kualifikohet.**

5. Operatori Ekonomik **Shoqëria Kupa sh.p.k**, me NIPT **K51615512C**, me vlerë të Ofertës: 61,086,178.21 (gjashtëdhjetë e njëmilion e tetëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë njëzetë e një) lekë pa TVSH.

S`kualifikohet

Arsyet si vijon:

Operatori Ekonomik Shoqëria **Shoqëria Kupa sh.p.k**, me NIPT **K51615512C** nuk ka paraqitur sipas pikës 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: pika a) Liçensën profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme, pasi nga dokumentacioni i dorëzuar në SPE rezulton se OE nuk disponon kategoritë e pikave të Licensës:

NS-9 Punime strukturore speciale.

Klasifikimi B

(OE disponon Kategorinë A)

Gjithashtu ky operator ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional, pasi në dokumentacionin e ngarkuar në SPE nuk ka ngarkuar asnjë dokumentacion për materialet hidraulike, autorizim prodhuesi, katalog për tuba, saracineskat.

Në përfundim të vlerësimit elektronik, ky Operator Ekonomik **S`Kualifikohet.**

6. Operatori Ekonomik **Shoqëria LIS KONSTRUKSION sh.p.k** me NIPT **K66613407H** me vlerë të Ofertës: 61,396,666.70 (gjashtëdhjetë e njëmilion e treqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtë pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

S`kualifikohet

Arsyet si vijon:

Operatori Ekonomik **Shoqëria LIS KONSTRUKSION sh.p.k** me NIPT **K66613407H** nuk ka paraqitur sipas pikës 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: pika a) Liçensën profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme, pasi nga dokumentacioni i dorëzuar në SPE rezulton se OE nuk disponon kategoritë e pikave të Licensës:

NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

Klasifikimi C

(OE disponon Kategorinë A)

Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 c) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i dorëzuar në rrugë elektronike rezulton se OE ka të punësuar: 1 teknik ndërtimi nga 2 që kërkohen, si dhe ai nuk disponon teknik topograf duke mos përmbushur kërkesat e bëra nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Operatori Ekonomik **Shoqëria LIS KONSTRUKSION sh.p.k** me NIPT **K66613407H**, nuk përmbush kriterin 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional, pasi në dokumentacionin e ngarkuar në SPE rezulton se nuk ka ngarkuar asnjë dokumentacion për materialet hidraulike :-Tuba dhe Rakorderi ujësjellësi PE100 RC PN10 deri në PN20; - Saracineska; - Rakorderi gize. Autorizimi i dorëzuar nga ky operator nuk është për materialet në rastin konkret Tuba PE 100 RC PN 10 deri në PN 20, por për materialet si me poshtë:

AUTORIZIM NGA PRODHUESI 01/24

Për mes këtij autorizimi NPT "FERPLAST" Nr.unik.biz : 810641002 me seli në Ferizaj , Republika e Kosovës I jep autorizim ndërmarrjes "**LIS KONSTRUKSION**" **Sh.P.K. Sh.P.K. NR. NIP. K66613407K , BULQIZË SHQIPËRI** si diler (blerës I prodhimeve tona), ka të drejtë që të përdor të dhënat e produkteve tona për konkurim në tender, të negocojë dhe të nënshkruajë kontratë me partnerët e vet , si në rastin konkretë :

Me prodhimet tona si vijon:

1. Tuba të brinjëzuar nga materiali HDPE të profileve ø110mm deri ID2000mm , standarti SN4 dhe SN8.
2. Tuba të ujsjellësit nga materiali HDPE 100 profileve prej ø20mm deri në ø630mm, me presion prej PN 6 deri në PN 25.
3. Tuba të ujsjellësit nga materiali HDPE 100 RC profileve prej ø20mm deri në ø630mm. me presion prej PN 6 deri në PN 25.
4. Tuba për transprotimin e kabllave optike ø32, ø40, ø50 dhe ø32, ø40, ø50 me tuba të bashkangjitur mes vete.
5. Tuba shtëpijak nga materiali PP-h nga ø50mm deri ø160mm
6. Tuba të brinjëzuar për transport dhe rollne prej ø16 deri në ø160mm
7. Tuba të brinjëzuar për drenazhim fi 110 deri ne fi 500mm
8. Puseta plastike për kanalizime fi 1000mm dhe fi 800mm
9. Bidona plastik 500L-5000L

Në përfundim të vlerësimit elektronik, ky Operator Ekonomik **S'Kualifikohet**

7. Operatori Ekonomik **Shoqëria S.M.O.Union sh.p.k** me **NIPT J66902042Q**, me vlerë të Ofertës: 60,732,183 (gjashtëdhjetëmilion e shtatëqind e tridhjetë dymijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

S'kualifikohet

Arsyet si vijon:

Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik në SPE për këtë procedurë prokurimi rezulton se nuk ka paraqitur sipas pikës 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: pika çertifikatat ISO të kërkuara në DST, konkretisht i mungon;

- Certifikatë SSH EN ISO 3834-2 :2021 "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim", ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë ISO 39001-2012 "Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në Trafikun Rrugor", ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Operatori Ekonomik **Shoqëria S.M.O.Union sh.p.k** me **NIPT J66902042Q** nuk plotëson pikën 2.3.3 a) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ku kërkohet që;

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, Drejtuesit Teknik si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

Pasi nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE rezulton se OE nuk disponon Inxhinier mjedisi dhe inxhinier hidroteknik .

Operatori Ekonomik **Shoqëria S.M.O.Union sh.p.k** me **NIPT J66902042Q** nuk plotëson pikën 2.3.3 c) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE rezulton se nuk disponon 1 teknik ndërtimi nga 2 që kërkohen, nuk disponon teknik topograf, nuk disponon hidraulik, nuk disponon saldator, nuk disponon hidroizolues, nuk disponon hekurthyes, nuk disponon specialist për punime betoni dhe nuk disponon automakinist, dhe nuk disponon buldozierist sipas pikës 2.3.3 e; duke mos përmbushur kërkesat e bëra nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Gjithashtu ky operator ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional, pasi në dokumentacionin e ngarkuar në SPE rezulton se nuk disponon materialet hidraulike, si dhe autorizim prodhuesi, katalog dhe ISO për materialet e kërkuara në DST.

Nuk përmbush kriterin **2.3.6** të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional në lidhje me makineri pajisje pasi nuk ka paraqitur pothuajse të gjitha makineritë e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në DST, si prsh: Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton, Eskavator me zinxhir, Fadroma me goma, Minieskavator, Minifadromë, Autobetonier, Autopompë, Autorimorkiator mjetesh, Motogjenerator / Gjenerator, Saldatrice / motosaldatrice, Pajisje për hekurthyes (tranxhe / elektrobango), Kompresor ajri, Depozitë uji 5000 lt, Sharrë asfalti, Pompë uji për pastrim, Tokmak për ngjeshje , Vibrator betoni, Betoniere 0.5m³, Betoniere kantieri, Nivelues Betoni, Aparat saldimit MIG TIG, Pajisje për testimin e presionit, Pompë presioni për testim hidraulik, Buldozer.

Në përfundim të vlerësimit elektronik, ky Operator Ekonomik **S`Kualifikohet**.

8. Operatori Ekonomik **Shoqëria "SARDO" sh.p.k** me **NIPT K13120402W**, me vlerë të Ofertës: 60,244,136 (gjashtëdhjetë milion e dyqind e dyzetë e katërmijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

S`kualifikohet

Arsyet si vijon:

Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik në SPE për këtë procedurë prokurimi rezulton se; Operatori Ekonomik **Shoqëria "SARDO" sh.p.k** me **NIPT K13120402W** nuk ka paraqitur sipas pikës 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: pika a) Liçensën profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme, pasi nga dokumentacioni i dorëzuar në SPE rezulton se OE nuk disponon kategoritë e pikave të Licensës:

Kategoria NP- 1 Punime gërmimi në tokë

Klasifikimi C

(OE disponon kategorinë B)

NS-9 Punime strukturore speciale.

Klasifikimi B

(OE disponon kategorinë A)

Si dhe rezulton se nuk disponon:

NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

Klasifikimi C

Operatori Ekonomik **Shoqëria "SARDO" sh.p.k** me **NIPT K13120402W** sipas **pikës 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit:** pika b) pasi nuk ka paraqitur asnjë nga çertifikatat ISO të kërkuara në DST.

Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, sipas standardeve:

- *Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikatë ISO 14001-2015 “Për sistemin e menaxhimit të mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikatë ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikatë SSH EN ISO 3834-2 :2021 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*
- *Certifikatë ISO 39001-2012 “Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në Trafikun Rrugor”, ose ekuivalente me të, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.*

Operatori Ekonomik **Shoqëria "SARDO" sh.p.k** me NIPT **K13120402W** nuk ka përmbush numrin mestar të punonjësve të kërkuar sipas pikës 2.3.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit:

Operatori Ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën 55 (pesëdhjetë e pesë) punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.

Gjithashtu nuk plotëson pikën 2.3.3 a) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ku kërkohet që;

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, Drejtuesit Teknik si më poshtë:

- *1 (një) Inxhinier Ndërtimi*
- *1 (një) Inxhinier Hidroteknik*
- *1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder*
- *1 (një) Inxhinier Mjedisi*
- *1 (një) Inxhinier Elektrik*

Operatori ekonomik nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE rezulton se nuk ka të punësuar: Inxhinier mjedisi, si dhe inxhinier Ndërtimi dhe hidroteknik, pasi rezulton se ka deklaruar një Drejtues Teknik për dy pozicione (*Ing. Ndërtimi dhe Ing.Hidroteknik*), si dhe numri mesatar i të punësuarve është 38 punonjës nga 55 që kërkohen duke mos përmbushur kërkesat e bëra nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Operatori Ekonomik **Shoqëria "SARDO" sh.p.k** me NIPT **K13120402W** nuk plotëson pikën 2.3.3 c) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ku kërkohet që;

c) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën 17 (shtatëmbëdhjetë) punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit

Operatori ekonomik nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE rezulton se nuk disponon: 1 teknik ndërtimi nga 2 që kërkohen, nuk disponon teknik topograf, disponon 1 hidraulik nga 3 që kërkohen, nuk disponon elektrikist, disponon 1 saldator ndërtimi nga 2 që kërkohen, disponon 1 karpentier nga 2 që kërkohen, nuk disponon hidroizolues, disponon 1 murator nga 2 që kërkohen, gjithashtu nuk disponon asnjë buldozierist sipas pikës 2.3.3 e; duke mos përmbushur kërkesat e bëra nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Operatori Ekonomik **Shoqëria "SARDO" sh.p.k** me NIPT **K13120402W** nuk ka paraqitur sipas pikës 2.3.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit: *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”*

Ky operator ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional, pasi në dokumentacionin e ngarkuar në SPE rezulton se nuk disponon materialet hidraulike, si dhe autorizim prodhuesi, katalog dhe ISO për materialet e kërkuara në DST.

Nuk përmbush kriterin **2.3.6** të kriterëve të veçanta të kualifikimit publikuar në DST për kapacitetin teknik dhe profesional në lidhje me makineri pajisje pasi nuk ka paraqitur makineritë: Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 -10 ton, Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 1.5 ton, Autovinc, Eskavator me zinxhir, Eskavator me goma, Fadroma me goma, Minifadromë, Autobetoniere, Autopompë, Autobot uji me sprucator, Autobitumatrice, Asfaltoshtruese, Autorimorkiator mjetesh, Rul ngjeshës gomë-hekur jo më pak se 10 ton, Rrul asfalti gomë-gomë, Rrul i vogël deri 6 ton, Motogjenerator / Gjenerator, Pajisje për hekurkthyes (tranxhe / elektrobango), Kompresor ajri, Sharrë asfalti, Tokmak për ngjeshje, Matrapik, Betoniere kantieri, Nivelues Betoni, Aparart saldimi MIG TIG, Pajisje për testimin e presionit, Pompë presioni për testim hidraulik, Buldozer.

Gjithashtu sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ky operator ai nuk disponon, Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit duke mos përmbushur kërkesat e bëra nga Autoriteti Kontraktor në DST.

Në përfundim të vlerësimit elektronik, ky Operator Ekonomik **S’Kualifikohet.**

Oferta të kualifikuara:

1. Operatori Ekonomik **Shoqëria Liqeni VII sh.p.k** me NIPT **K01730502W** me vlerë të Ofertës: 58,124,671 (pesëdhjetë e tetëmilion e njëqind e njëzetë e katërmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Kualifikohet

Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik **Shoqëria Liqeni VII sh.p.k** me NIPT **K01730502W**, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, konkludon se ky Operator Ekonomik plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranimit /Kualifikimit.

Ky Operator dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik e ka të rregullt konform kërkesave të Dokumentave Standarte të Tenderit. Gjithashtu plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në zbatim të Legjislacionit të Prokurimit Publik, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor ka vendosur të pranojë ofertën e Operatorit Ekonomik **Shoqëria**

Liqeni VII sh.p.k me **NIPT K01730502W**, si dhe të kualifikojë si ofertë të vlefshme ofertën e paraqitur prej tij.

Në përfundim të vlerësimit elektronik, ky Operator Ekonomik, **Kualifikohet**

2. Operatori Ekonomik **Shoqëria S I R E T A 2F sh.p.k** me **NIPT K51501008J sh.p.k**, me vlerë të Ofertës: 61,111,111 (gjashtëdhjetë e njëmilion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Kualifikohet

Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik **Shoqëria S I R E T A 2F sh.p.k** me **NIPT K51501008J sh.p.k**, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, konkludon se ky Operator Ekonomik plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranimit /Kualifikimit.

Ky Operator dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik e ka të rregullt konform kërkesave të Dokumentave Standarte të Tenderit. Gjithashtu plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në zbatim të Legjislacionit të Prokurimit Publik, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor ka vendosur të pranojë ofertën e Operatorit Ekonomik **Shoqëria S I R E T A 2F sh.p.k** me **NIPT K51501008J sh.p.k**, si dhe të kualifikojë si ofertë të vlefshme ofertën e paraqitur prej tij.

Në përfundim të vlerësimit elektronik, ky Operator Ekonomik, **Kualifikohet**

Autoriteti Kontraktor në përfundim konkludoi:

Oferta të refuzuara:

1. Bashkimi Operatorëve Ekonomik **Shoqëria B93 II sh.p.k** me **NIPT L522090500 Sh.p.k & Shoqëria BEQIRI** me **NIPT J98624801V**, me vlerë të ofertës: 54,222,208 (pesëdhjetë e katërmilion e dyqind e njëzetë e dymijë e dyqind e tetë) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik **Shoqëria Balili Konstruksion sh.p.k** me **NIPT K17016202S Sh.p.k** me vlerë të Ofertës: 61,592,683 (gjashtëdhjetë e njëmilion e pesëqind e nëntëdhjetë e dymijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik **Shoqëria Desaret Company sh.p.k** me **NIPT K01816001J Sh.p.k** me vlerë të Ofertës: 42,519,894.02 (dyzetë e dymilion e pesëqind e nëntëmbëdhjetëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër pikë zero dy) lekë pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik **Shoqëria Ideal Construction And Projection (I.C.P) sh.p.k** me **NIPT L91310511L**, me vlerë të Ofertës: 60,852,609.67 (gjashtëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë dymijë e gjashtëqind e nëntë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
5. Operatori Ekonomik **Shoqëria Kupa sh.p.k**, me **NIPT K51615512C**, me vlerë të Ofertës: 61,086,178.21 (gjashtëdhjetë e njëmilion e tetëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë njëzetë e një) lekë pa TVSH.
6. Operatori Ekonomik **Shoqëria LIS KONSTRUKSION sh.p.k** me **NIPT K66613407H** me vlerë të Ofertës: 61,396,666.70 (gjashtëdhjetë e njëmilion e treqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.
7. Operatori Ekonomik **Shoqëria S.M.O.Union sh.p.k** me **NIPT J66902042Q**, me vlerë të Ofertës: 60,732,183 (gjashtëdhjetëmilion e shtatëqind e tridhjetë dymijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.
8. Operatori Ekonomik **Shoqëria "SARDO" sh.p.k** me **NIPT K13120402W**, me vlerë të Ofertës: 60,244,136 (gjashtëdhjetë milion e dyqind e dyzetë e katërmijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Oferta të kualifikuara:

1. Operatori Ekonomik **Shoqëria Liqeni VII sh.p.k** me **NIPT K01730502W** me vlerë të Ofertës: 58,124,671 (pesëdhjetë e tetëmilion e njëqind e njëzetë e katërmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik **Shoqëria S I R E T A 2F sh.p.k** me **NIPT K51501008J sh.p.k**, me vlerë të Ofertës: 61,111,111 (gjashtëdhjetë e njëmilion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

* * *

Duke u nisur nga renditja e operatoreve ekonomikë të kualifikuar, në bazë të kriterit të përzgjedhjes Çmimi më i ulët, konkludohet se Oferta fituese është Oferta e Operatorit Ekonomik Shoqëria **Shoqëria Liqeni VII sh.p.k** me **NIPT K01730502W**, me vlerë të ofertës 58,124,671 (pesëdhjetë e tetëmilion e njëqind e njëzetë e katërmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Pas paraqitjes nga Operatori Ekonomik **Shoqëria Liqeni VII sh.p.k** me **NIPT K01730502W**, të dokumentacionit provues të parashikuar në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të nenit 26 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ky operator ekonomik rezultoi me dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik të rregullt konform kërkesave të Dokumentave Standarte të Tenderit të publikuara nga Autoriteti Kontraktor.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik **Shoqëria Liqeni VII sh.p.k** me **NIPT K01730502W** me adresë: Durrës, Shkozë, Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007, me ofertë të paraqitur me një vlerë totale prej 58,124,671 (pesëdhjetë e tetë milion e njëqind e njëzetë e katërmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH/ totali i pikëve të marra [_____]; se është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR